



A.nr.581/2026

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Arben Mehmeti, kryetar, Ardita Haxhnikaj Demi dhe Malsore Gashi Bajraktari, anëtarë, me Avdyl Bekteshi, në cilësinë e procesmbajtësit, ka shqyrtuar ankesën A.nr.581/2026 të datës 29.05.2026, të parashtruar nga ankuesi B.H, nga Prishtina, kundër organit të punësimit: Sekretariati i Këshillit Gjyqësor të Kosovës, në çështjen juridike, “*kontestim konkursi*”, duke vepruar në mbështetje të nenit 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1, nenit 16 paragrafi 3 dhe nenit 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 23.07.2026, mori këtë:

V E N D I M

I. Refuzohet si e pabazuar ankesa A.nr.581/2026, e datës 29.05.2026, e parashtruar nga ankuesi B.H.

II. Mbetet në fuqi Lista e rezultateve përfundimtare e datës 26.05.2026, lidhur me konkursin për pozitën Zyrtar Ligjor-Projekt i UNDP, të shpallur nga Sekretariati i Këshillit Gjyqësor të Kosovës, për Gjykatën Themelore në Prishtinë dhe Gjykatën e Apelit.

A r s y e t i m

Ankuesi B.H (në tekstin e mëtejme referuar: Ankuesi) më datë 29.05.2026, ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër rezultatit përfundimtar të datës 26.05.2026, lidhur me konkursin për pozitën Zyrtar Ligjor-Projekt i UNDP, të shpallur nga Sekretariati i Këshillit Gjyqësor të Kosovës, për Gjykatën Themelore në Prishtinë dhe Gjykatën e Apelit.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil i Kosovës, (në tekstin e mëtejme referuar: Këshilli) bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit të Ankesave, me datë 04.06.2026 ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë tek Sekretariati i Këshillit Gjyqësor të Kosovës, ndërsa ky i fundit, me datë 17.06.2026 dhe 29.06.2026, ka përcjellë përgjigjën në ankesë se bashku me dokumentet e bashkangjitura të lëndës në çështjen përkatëse ankimore.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave (në tekstin e mëtejme referuar: Kolegji i Këshillit) pas konstatimit se ankesa është e pranueshme në kuptim të dispozitave të nenit 129 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, vendosi për shqyrtimin e të njëjtës, kështu që për vendosje meritore administroi këto prova: Ankesën me numër protokolli 2493/2026, të datës 29.05.2026, të parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për

Shërbimin Civil të Kosovës; Kopjen e ID-së së ankuesit; Dokumentet plotësuese nga ankuesi Diploma me Nr. 6888; Certifikatën me Nr. 35-642 të datës 23.09.2024; Kontratë për punë për periudhën të caktuar e lidhur mes ankuesit dhe Avokatisë Elsë Musa SHPK; Certifikatë e gjuhës angleze; Certifikatë trajnimi për periudhën 12.11.2028 deri 12.12.2018; Certifikatë e datës 30.11.2021; Certifikatë për periudhën 14.03.2019 deri 02.05.2019; Certifikatë për studentin bursist 2018/2019; Certifikatën për periudhën 05-20.10.2019; Reference e datës 25.05.2021; Licencë e datës 19.04.2025; Certifikatë e datës 18.02.2021; Shkresë e datës 28.05.2026 nga ankuesi për Komisionin e Pranimi për kandidatët për pozitën Zyrtar Ligjor (projekt UNDP); Kërkesën për përgjigje në ankesë e datës 04.06.2026; Përgjigjen në ankesë e datës 17.06.2026 dhe 29.06.2026; Kërkesën për punësim të ankuesit me të gjitha dokumentet e bashkëngjitura; Kërkesën për punësim të kandidateve fituese Hamide Makolli, Fitore Qehaja dhe Donika Berisha gjitha dokumentet e bashkëngjitura; Formularët e vlerësimit të intervistës me gojë për ankuesin dhe të kandidateve fituese Hamide Makolli, Fitore Qehaja dhe Donika Berisha; Lista e rezultateve përfundimtare e datës 26.05.2026, lidhur me konkursin për pozitën Zyrtar Ligjor-Projekt i UNDP, të shpallur nga Sekretariati i Këshillit Gjyqësor të Kosovës, për Gjykatën Themelore në Prishtinë dhe Gjykatën e Apelit; Konkursin me Nr. 01/2026 për pozitën Zyrtar Ligjor, për realizimin e projektit në bashkëpunim me UNDP, për Gjykatën Themelore në Prishtinë një pozitë dhe Gjykatën e Apelit dy pozita.

Kolegji i Këshillit bazuar në shkresat e lëndës të dërguara nga palët në procedurë si dhe bazuar në legjislacionin përkatës, ka konstatuar se ankesa është e pabazuar, **sepse:**

Nga administrimi i shkresat e lëndës rezulton se Sekretariati i Këshillit Gjyqësor të Kosovës, më datë 07.05.2026, ka shpallur Konkursin me Nr. 01/2026 për pozitën Zyrtar Ligjor, për realizimin e projektit në bashkëpunim me UNDP, për Gjykatën Themelore në Prishtinë një pozitë dhe Gjykatën e Apelit dy pozita.

Në këtë konkurs ka aplikuar edhe ankuesi i cili është përfshirë në fazën e intervistimit me gojë, dhe sipas njoftimit për rezultatet përfundimtare të datës 26.05.2026, rezulton se për pozitën Zyrtar Ligjor në Gjykatën Themelore në Prishtinë kandidatë me më së shumti pikë janë Hamide Makolli me 71.67 pikë, ndërsa ankuesi i dyti me 69.00 pikë, ndërsa për pozitën Zyrtar Ligjor në Gjykatën e Apelit kandidatët me më së shumti pikë janë Fitore Qehaja me 78.67 ikë, dhe Donika Berisha me 75.67 pikë, ndërsa ankuesi është renditur i pesti me 69.00 pikë.

Ankuesi në ankesën e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, pretendon se në pyetjet që jam përgjigjur saktë nuk janë dhënë pikët maksimale por më janë dhënë 6 pikë. Në CV jam vlerësuar më 17 pikë nga 30 të mundshme që nuk është reale sepse kam përvojë pune të mjaftueshme. Kërkon që të shikohet CV edhe e kundër kandidateve.

Ndërsa në kuptim të shqyrtimit të pretendimeve ankimore të ankuesit, Kolegji i Këshillit i'u referua dispozitave të Ligjit Nr.08/L-197 për Zyrtarët Publikë, përkatësisht nenit 6 paragrafi 4, ku përcaktohet se: *“4. Të punësuarat/it e administratës në kuadër të sistemit të drejtësisë, Gjykatës Kushtetuese, Presidencës, Kuvendit të Republikës së Kosovës, si dhe institucioneve të pavarura kushtetuese janë nëpunës civil me status të veçantë, rregullimi i të cilëve bëhet me akt të veçantë”*, e duke marr për bazë këtë Këshilli Gjyqësor i Kosovës ka nxjerr Rregulloren Nr. 04/2024 për Themelimin e Marrëdhënies së Punës me Kontratë për një Periudhë të Caktuar në Administratën e Sistemit Gjyqësor.

Kolegji i Këshillit, konstaton se sipas konkursit me Nr. 01/2026 për pozitën Zyrtar Ligjor, si kualifikime arsimore dhe profesionale dhe përvoja e punës janë kërkuar: *1. Diplome Universitare: Jurist i diplomuar dhe 2. Një (1) vit përvojë pune.*

Kolegji i Këshillit, lidhur me këtë çështje, ju referuar, Ligjit Nr. 08/L-197 për Zyrtarët Publikë, respektivisht nenit 37 paragrafi 1 dhe 3, ku përcaktohet: *“1. Marrëdhënia e punës sipas këtij kapitulli është marrëdhënie juridike ndërmjet shtetit dhe nëpunëses/it civil që themelohet me aktin e emërimit, përveç në rastet kur parashikohet ndryshe me dispozitat e këtij ligji. 3. Përjashtimisht nga paragrafi 1. i këtij neni, marrëdhënia e punës në shërbimin civil mund të themelohet me kontratë për një periudhë të caktuar në këto raste: 3.1. për realizimin e projektit të caktuar të institucionit përkatës; 3.2. për plotësimin e një pozite në rast të mungesës së përkohshme”* dhe Rregullores Nr. 04/2024 për Themelimin e Marrëdhënies së Punës me Kontratë për një Periudhë të Caktuar në Administratën e Sistemit Gjyqësor, gjegjësisht nenit 12 paragrafi 2, 3, 4, 5, 6, 7 dhe 8, ku përcaktohet: *“2. Faza e vlerësimit profesional përbëhet nga intervista dhe vlerësimi i jetëshkrimit dhe zhvillohet nga komisioni i përzgjedhjes me mbështetjen e NjMBNj. 3. Në intervistë, vlerësohen njohuritë, aftësitë dhe cilësitë e kërkuara në shpalljen e konkursit. 4. Intervista që zhvillohet është intervistë e strukturuar nga komisioni i përzgjedhjes, i cili përgatit grup pyetjesh të njëjta për të gjithë kandidatët për intervistën. 5. Intervista përmban dhjetë (10) pyetje, ku secila vlerësohet me më së shumti shtatë (7) pikë. Përveç pyetjeve, anëtarët e komisionit të përzgjedhjes mund të parashtrojnë edhe nën pyetje për kandidatin me qëllim të vlerësimit më të saktë të kandidatit lidhur me pyetjen kryesore. 6. Në intervistë kandidati mund të merr më së shumti njëqind (100) pikë, prej të cilave tridhjetë (30) pikë për jetëshkrimin (CV). 7. Vlerësimi maksimal për jetëshkrimin ndahet si vijon: 7.1. deri në dhjetë (10) pikë për arsimimin; 7.2. deri në pesëmbëdhjetë (15) pikë për përvojën relevante në punë; dhe 7.3. deri në pesë (5) pikë për trajnimet relevante. 8. Secili nga anëtarët e komisionit të përzgjedhjes bën vlerësimin e detajuar për secilën pyetje dhe jetëshkrimin, si dhe minimumi dhe maksimumi i vlerësimit duhet të jetë i arsyetuar me shkrim, ndërsa sipas nenit 13 paragrafi 1, 3 dhe 4 të kësaj rregulloreje përcaktohet: “1. Vlerësimi përfundimtar i intervistës dhe jetëshkrimit për një kandidat është mesatarja aritmetike e vlerësimeve të të gjithë anëtarëve. 3. Lista publikohet në SIMBNj (kur e njëjta të jetë funksionale), dhe në faqen zyrtare të Këshillit. 4. Kandidati që merr më së shumti pikë por jo më pak se pragu prej shtatëdhjetë (70) pikëve, konsiderohet kandidat fitues”.*

Përkritazi me dispozitat ligjore të cekura më lart, Kolegji i Këshillit, ka shqyrtuar pretendimet ankimore të ankuesit e për rrjedhojë edhe vlerësimin e bërë nga Komisioni Përzgjedhës dhe dosjet e kandidateve fitues për pozitat përkatëse, andaj ndërlidhur me procedurën e pranimit për pozitën Zyrtar Ligjor në Gjykatën Themelore në Prishtinë, dhe ka konstatuar se sipas kërkesës për punësim të ankuesit dhe dokumenteve të bashkëngjitura rezulton se i njëjti posedon Diplomën me Nr. 6886 të datës 10.06.2020 të lëshuar nga Universiteti i Prishtinës “Hasan Prishtina”, me të cilën dëshmohet se më datës 30.01.2020 ka përfunduar studimet themelore në Fakultetin Juridik duke marr titullin Jurist i Diplomuar-Bachelor, ndërlidhur me përvojën e punës posedon Certifikatën AGJ.nr.127/2021 të datës 18.02.2021 të lëshuar nga Gjykata e Apelit e Kosovës, me të cilën dëshmohet se ka përfunduar praktikën gjyqësore prej datës 18.02.2020 deri më datë 18.02.2021, si dhe posedon Kontratën e Punës për Periudhë të pacaktuar të lidhur mes tij dhe Avokaturës Elsë Musa SHPK, me të cilën dëshmohet se ka qenë në marrëdhënie pune si Bashkëpunëtor Profesional duke filluar nga data 15.11.2023 deri më datë 15.11.2024 siç është deklaruar edhe në kërkesën për punësim nga ankuesi po ashtu edhe të dokumentuar me pasqyrën e kursimeve

pensionale. Sipas kërkesës për punësim të kandidatës fituese, Hamide Makolli e njëjta posedon Diplomën me Nr. 5123 të datës 18.10.2017 të lëshuar nga Universiteti i Prishtinës “Hasan Prishtina”, me të cilën dëshmohet se më datë 12.07.2017 ka përfunduar studimet themelore në Fakultetin Juridik duke marrë titullin Jurist i Diplomuar-Bachelor, ndërlidhur me përvojën e punës sipas Certifikatës së datës 14.10.2020 të lëshuar nga Gjykata Themelore në Prishtinë ka përfunduar praktikën gjyqësorë nga data 13.05.2019 deri më datën 12.05.2020, sipas Vërtetimit të datës 10.09.2024 nga data 01.04.2021 deri më datë 30.06.2024 ka qenë e punësuar në pozitën Asistente Administrative/Zyrtare Ligjore në Shoqërinë e Avokatëve Klinaku&Associates, sipas Kontratës së Punës të lidhur me Avokat Naim Rudari për periudhën 01.10.2024 deri më datë 01.04.2025 e ku këto përvoja të punës i ka të mbështetura edhe më dëshmi nga trusti i kursimeve pensionale. Rrjedhimisht Kolegji i Këshillit, konstaton se të dy kandidatët edhe kandidatja fituese por edhe ankuesi kanë plotësuar kërkesat e konkursit ndërlidhur me kualifikimin e kërkuar dhe përvojën e punës. Sa i përket vlerësimit të intervistës për ankuesin dhe kandidaten fituese përmes formularëve të vlerësimit të intervistës me gojë nga anëtarët e Komisionit Përzgjedhës, rezultojnë se vlerësimi i jetëshkrimit CV-së, ka qenë standard për të dy pra ka qenë vlerësim i njëjtë, pra për Arsimimin ka qenë nga 5, për përvojën relevante të punës nga 10 pikë dhe për trajnimet relevante nga dy pikë, pra është përdorur standardi i njëjtë, ndërsa sipas vlerësimit të intervistës me gojë, ankuesi nga anëtarët e Komisionit Përzgjedhës është vlerësuar me totalin e pikëve si në vijim: 61, 75 dhe 71, ndërsa kandidatja fituese është vlerësuar me totalin e pikëve si në vijim: 69, 75, 71, e që sipas mesatares aritmetike ankuesi ka marrë 69 pikë, ndërsa kandidatja fituese 71.67, pra sipas provave të lëndës, rezultojnë se në raport me vlerësimin e jetëshkrimit, nuk ka vlerësim jo real ndaj ankuesit për shkak që për të dy kandidatët është përdorur formulë e njëjtë e vlerësimit dhe pikët kanë qenë të ngjashme, ndërsa në raport me vlerësimin e intervistës me gojë, Kolegji i Këshillit, vlerëson se është diskrecion i Komisionit Përzgjedhës që vlerësimi të bëhet sipas përgjigjeve të dhëna nga kandidatët, kështu që pretendimi i ankuesit nuk rezultojnë të ketë mbështetje juridike.

Lidhur me procedurën e pranimit për pozitën Zyrtar Ligjor në Gjykatën e Apelit, Kolegji i Këshillit, ka konstatuar se në këtë procedurë kanë rezultuar dy kandidatë fitues, dhe nga shqyrtimi i dosjeve të kandidatëve rezultojnë se sipas kërkesës për punësim të ankuesit dhe dokumenteve të bashkëngjitura rezultojnë se i njëjti posedon Diplomën me Nr. 6886 të datës 10.06.2020 të lëshuar nga Universiteti i Prishtinës “Hasan Prishtina”, me të cilën dëshmohet se më datë 30.01.2020 ka përfunduar studimet themelore në Fakultetin Juridik duke marrë titullin Jurist i Diplomuar-Bachelor, ndërlidhur me përvojën e punës posedon Certifikatën AGJ.nr.127/2021 e datës 18.02.2021 të lëshuar nga Gjykata e Apelit e Kosovës, me të cilën dëshmohet se ka përfunduar praktikën gjyqësore prej datës 18.02.2020 deri më datë 18.02.2021, si dhe posedon Kontratën e Punës për Periudhë të pacaktuar të lidhur me tij dhe Avokaturës Elsie Musa SHPK, me të cilën dëshmohet se ka qenë në marrëdhënie pune si Bashkëpunëtor Profesional duke filluar nga data 15.11.2023 deri më datë 15.11.2024 siç është deklaruar edhe në kërkesën për punësim nga ankuesi, po ashtu edhe të dokumentuar me pasqyrën e kursimeve pensionale. Sipas kërkesës për punësim të kandidatës fituese, Fitore Qehaja e njëjta posedon Diplomën me Nr.4108/22 të datës 04.11.2022 të lëshuar nga Kolegji AAB, me të cilën dëshmohet se më datë 05.07.2022 ka përfunduar studimet themelore në Programin Juridik duke marrë titullin LLB në Juridik, ndërlidhur me përvojën e punës sipas Certifikatës të datës 11.03.2025 të lëshuar nga Gjykata Themelore në Prishtinë ka përfunduar praktikën gjyqësore nga data 12.03.2024 deri më datën 11.03.2025, sipas Kontratës së Punës të lidhur me Ndërmarrjes Publike Lokale “Prishtina Parking” e njëjta nga data 16.05.2022 deri më datë 15.07.2022 ka punuar si Zyrtare për Arkivë. Kandidatja Donika Berisha, sipas kërkesës për punësim posedon

Diplomën me Nr.7313 të datës 24.12.2020 të lëshuar nga Universiteti i Prishtinës “Hasan Prishtina”, me të cilën dëshmohet se më datë 23.09.2020 ka përfunduar studimet themelore në Fakultetin Juridik duke marr titullin Jurist i Diplomuar-Bachelor, ndërlidhur me përvojën e punës posedon Certifikatën e datës 11.03.2024, të lëshuar nga Gjykata Themelore në Prishtinës me të cilën dëshmohet se ka përfunduar praktikën gjyqësore prej datës 13.03.2023 deri më datë 12.03.2024, ndërsa përvojat tjera si praktikante të këtyre dy kandidateve nuk mund të merren parasysh për faktin se sipas nenit 16 paragrafi 4 të Ligjit Nr. 03/L-212 të Punës, përcaktohet: *“4. Puna praktike e praktikantit me përgatitje pasuniversitare, universitare dhe të lartë mund të zgjasë më së shumti një (1) vit, ndërsa puna praktike e praktikantit me shkollim të mesëm mund të zgjasë më së shumti gjashtë (6) muaj”*, e duke qenë se këto kandidate kanë disa përvoja pune si praktika atëherë merret parasysh vetëm ajo që e ka në Gjykatën Themelore në Prishtinë. Rrjedhimisht Kolegji i Këshillit, konstaton se edhe ankuesi dhe kandidatët fituese kanë plotësuar kërkesat e konkursit ndërlidhur me kualifikimin e kërkuar dhe përvojën e punës. Sa i përket vlerësimit të intervistës për ankuesin dhe kandidatët fituese përmes formularëve të vlerësimit të intervistës me gojë nga anëtarët e Komisionit Përzgjedhës, rezulton se vlerësimi i jetëshkrimit CV-së, ka qenë standard për kandidatët pra ka qenë vlerësim i njëjtë pra për Arsimimin ka qenë nga 5, për përvojën relevante të punës nga 10 pikë dhe për trajnimet relevante nga dy pikë, pra është përdorur standardi i njëjtë, ndërsa sipas vlerësimit të intervistës me gojë, ankuesi nga anëtarët e Komisionit Përzgjedhës është vlerësuar me totalin e pikëve si në vijim: 61, 75 dhe 71 apo nga mesatarja aritmetike 69 pikë, kandidatja fituese Fitore Qehaja është vlerësuar me totalin e pikëve si në vijim: 77, 80, 79 apo mesatarja aritmetike 78.67 pikë, ndërsa kandidatja fituese Donika Berisha, është vlerësuar me totalin e pikëve si në vijim: 83, 71, 73 apo mesatarja aritmetike 75.67 pikë. Pra sipas provave të lëndës, rezulton se në raport me vlerësimin e jetëshkrimit, nuk ka vlerësim jo real ndaj ankuesit për shkak që kandidatët është përdorur formulë e njëjtë e vlerësimit dhe pikët kanë qenë të ngjashme, ndërsa në raport me vlerësimin e intervistës me gojë, Kolegji i Këshillit, vlerëson se është diskrecion i Komisionit Përzgjedhës që vlerësimit të bëjë sipas përgjigjeve të dhëna nga kandidatët, kështu që pretendimi i ankuesit nuk rezulton të ketë mbështetje juridike.

Andaj, duke marr parasysh konstatime si më sipër, Kolegji i Këshillit, vlerëson se Lista e rezultateve përfundimtare e datës 26.05.2026, lidhur me konkursin për pozitën Zyrtar Ligjor-Projekt i UNDP, të shpallur nga Sekretariati i Këshillit Gjyqësor të Kosovës, për Gjykatën Themelore në Prishtinë dhe Gjykatën e Apelit, është në pajtim me dispozitat e nenit 13 paragrafi 4 të Rregullores Nr. 04/2024 për Themelimin e Marrëdhënies së Punës me Kontratë për një Periudhë të Caktuar në Administratën e Sistemit Gjyqësor.

Andaj, theksuar si më sipër e në mbështetje të nenit 18 paragrafi 1, nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji i Këshillit, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Administrative në Prishtinë- Departamenti për Konteste të Punës, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda:A.nr.581/2026, më datë 23/07/2026

Avdyl BEKTESHI

Arben MEHMETI

Procesmbajtës

Kryetar i Kolegjit

Vendimi i dërgohet:

- Ankuesit B.H;
- Udhëheqësit të Njesisë së Burimeve Njerëzore në Sekretariatit e Këshillit Gjyqësor të Kosovës; dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.